

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Mejreme Memaj, kryetar, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.D. nga Prizreni dhe, për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KP, duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit I.D., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.106/2017 datë 21.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 22.02.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.106/2017 datë 21.11.2017, vetëm sa i përket vendimit mbi dënim për të akuzuarin I.D., ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarit I.D., për veprën për të cilën është shpallë fajtor, e gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.01.2017 deri me datën 16.05.2017, ndërsa dënimi me gjobë në shumë prej 300€, i merret si i vërtetuar.

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit I.D..

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin, P.nr.106/2017 datë 21.11.2017, të akuzuarin I.D. e ka shpallë fajtor për shkak të veprës Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KP, për çka e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.01.2017 deri me datën 16.05.2017 dhe me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg në mënyrë që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të caktoj një ditë burgu pra 15 ditë burg. Prej të akuzuarit konfiskohet substanca narkotike “marihuan” në peshë prej 512.32 gram dhe peshorja “arsum san” si objekt i kryerjes së veprës penale. Obligohet i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 euro në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënim me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon ankesën ashtu që të akuzuarit I.D. ti shqiptoj një dënim më të lartë me burgim.

-Mbrojtësja e të akuzuarit I.D., av. E.Gj., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta anulon aktgjykimin e shkallës së parë dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje ose të njëjtën ta ndryshoj dhe ndaj tij të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPP-së, e në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit, edhe mbrojtësja e të akuzuarit av.E.Gj. edhe pse të ftuar me rregull, kurse prezent ishte i akuzuari I.D.. I akuzuari mbeti pran pretendimeve ankimore në ankesë të ushtruar nga mbrojtësja e tij.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.22/2018 të dt. 17.01.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të aprovohet si e bazuar kurse ajo e mbrojtëses së të akuzuarit I.D. të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat nuk janë të bazuara.

Mbrojtja në ankesë pretendon se Aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.12 ngase nuk është i përpiluar në pajtim me nenin 370 par.7 të KPP-së, meqenëse në rastin konkret gjykata nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara dhe se respektivisht në mënyrë të veçantë nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse arsyet e mos miratimit konkret të palëve si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje penale e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit. Mbrojtja thekson se i akuzuari as që ka blerë pa autorizim e as që ka shitur apo shpërndarë mjetet narkotike siç ngarkohet me aktakuzën e Prokurorit të Shtetit, në të vërtetë i akuzuari ka pranuar se pjesa e substancës narkotike e gjetur në shtëpinë e tij ka qenë kryesisht për përdorim personal sepse i njëjti është përdorues i rregullt i substancave narkotike me se 40 vite. Ndërsa pjesa e tjetër e substancës e cila është gjendur në lokal i akuzuari nuk ka pasur dijeni se kush e ka lënë atë. Përkritazi me gjendjen faktike duhet theksuar se Policia ka bastisur lokalin pa prezencën e tij dhe pa prezencën e dy dëshmitarëve e më pastaj e kanë bastisur shtëpinë e ti, e me pastaj e kanë bastisur prapë lokalin në prezencën e tij dhe në atë rast e kanë gjetur paketime të substancës narkotike. Gjykata në asnjë provë nuk ka mundur të vërtetoj në mënyrë të sigurt se i njëjti ka shitur, ka blerë në mënyrë të paautorizuar ka shpërndarë substanca narkotike. Sa i përket fajësisë meqenëse kemi të bëjmë me veprën penale të kualifikuar me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti si me dashje direkte e as me dashje eventuale të ketë kryer veprën penale për et cilën është akuzuar. Po ashtu gjykata nuk ka mundur me asnjë provë ta vërtetoj motivin e kryerjes së veprës penale por vetëm faktin se i akuzuari është deklaruar se është përdorues i këtyre substancave.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Dispozitivi i aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, dhe se provat e administruara në shqyrtimin kryesorë janë në përputhje me ato që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe të cilat janë arsyetuar secila veç e veç, duke vlerësuar relevancën e secilës provë në raport me provat tjera, dhe duke dhënë arsyet se përse disa provave ua fali besimin gjykata e disave jo. Arsyet e dhëna lidhur me vlerësimin e secilës provë nga gjykata e shkallës së parë, të njëjtat në tërësi i pranon edhe kjo gjykatë duke konsideruar se nuk ka nevojë që edhe një herë të elaborohen gjegjësisht të njëjtat do të potencohen në pjesën që ka të bëjë me gjendjen faktike. Sa i përket pretendimit të mbrojtëses të akuzuarit I.D. e që ka të bëjë me gjendjen faktike edhe në këtë drejtim ankesa është e pa bazuar pasi që gjykata ka administruar provat siç janë raporti i vendit të ngjarjes i dt. 31.01.2017 e ku vërtetohet se me datë 27.01.2017 rreth orës 14,55 pas bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit I.D. e cila gjendët në Prizren është gjetur sasia e substancës narkotike marihuan e po ashtu një sasi e narkotikut është gjetur në xhepin e jaknes e cila ka qenë e varur në lokalin e të akuzuarit, është lexuar lista e dëshmimeve e përpiluar në bazë të bastisjes në shtëpinë dhe lokalin e të akuzuarit e ku janë përshkruar sendet të cilat janë konfiskuar e që ndërlidhen me veprimet inkriminuese të akuzuarit, është bërë shikimi në fotoalbumin e datës 27.01.2017 i kryer gjatë bastisjes e ku vërehen dëshmitë e evidentuara si në listën e dëshmimeve, procesverbali i bastisjes i datës 27.01.2017, raporti i AKF/2017- 05.09.2017-458 datë 30.03.2017 ku janë ekzaminuar substancat narkotike, demantojnë pretendimet e mbrojtjes se i njëjti sasinë e narkotikut e ka pasur për përdorim personal e jo për shitje dhe shpërndarje të së njëjtës e po ashtu edhe pretendimin se nuk e din se kush e ka lënë narkotikun në xhepin e jaknes së tij që është gjetur në lokalin e tij. Prandaj gjykata bazuar në këto prova me të drejtë ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit I.D. formohen të gjitha elementet e veprës penale nga neni 273 par.1 të KPRK.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit se ky dënim nuk është proporcional me shkallën e rrezikut shoqërorë, shakllën e rrezikut të vlerës së mbrojtur si dhe sasinë e narkotikut.

Rrethanat e vlerësuar të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit Iliri Dida , sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë të natyrës së atillë që të ndikojnë që në rastin konkret të akuzuarit, për këtë vepër penale t'i shqiptohet një dënim kaq i ulët prej 6 muaj burgim, kur kihet parasysh pesha e veprës penale, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe sasia e narkotikut, prandaj kjo gjykatë të akuzuarit i shqiptoi dënimet sikur se në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku edhe në shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e Apelit e Kosovës i ka shqiptuar të akuzuarit dënim në minimumin e paraparë ligjor (pasi që minimumi i paraparë për këtë vepër penale është 2 vjet), duke marrë si rrethanë veçanërisht lehtësuese se është i divorcuar dhe jeton në kushte të vështira ekonomike, me bindje se ky dënim është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Duke pasur parasysh këto që u thanë më lartë rreth vendimit mbi dënim, kjo gjykatë e refuzoi si të pa bazuar ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.14/2018, më 22.02.2018

Procesmbajtëse,
Suzane Goxhuli_____

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti_____